



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Pranuar nga data: 29.03.2024			
Niveli i programit:	Nomer:	Serija:	Vlera:
	01	787	

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" PUBLIC UNIVERSITY
GJILAN

RAPORT VJETOR I PUNËS

2023

Gjilan, Mars 2024

Përmbajtja

Përmbajtja	3
Lista e tabelave	4
Fjala hyrëse e Rektorit	5
HYRJE	7
METODOLOGJIA E HARTIMIT	7
1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE TË ARRITURA	8
2. PUNA E ORGANEVE QE VERISËSE	17
2.1. Të dhëna për Këshillin Drejtues	17
2.2. Të dhëna për Senatin	19
3. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME STATISTIKORE	22
3.1. Buxheti (fondet publike dhe private)	22
3.2. Personeli (shifrat zhvillimore)	27
3.3. Infrastruktura	35
3.1.1. Raporti i Prokurimit	37
3.4. Profili akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.)	48
3.5. Programet e studimit	48
3.6. Numri i studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit)	53
3.7. Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet)	62
3.8. Bashkëpunimi ndërkombëtar	74

Lista e tabelave

Tabela 1: UKZ ka aplikuar për Ri/Akreditim të programeve studimore	15
Tabela 2: Buxheti dhe Shpenzimet Janar – Dhjetor 2023.....	23
Tabela 3: Fondet burimore.....	24
Tabela 4: Të hyrat vetanake	25
Tabela 5: Shpenzimet e projekteve (fondi burimor 49)	26
Tabela 6: Personeli akademik	29
Tabela 7: Numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë.....	34
Tabela 8: Stafi akademik dhe administrativ.....	34
Tabela 9: Zyrat e KD, menaxhmentit, dekanëve, stafit akademik, stafit administrativ, parlamentit studentor dhe depos.....	35
Tabela 10: Sallat e mësimit, kabinetet e informatikës dhe laboratorët	36
Tabela 11: Aktiviteti i Prokurimit.....	41
Tabela 12: Pajisjet.....	46
Tabela 13: Pajisjet.....	46
Tabela 14: Numri i kompjuterëve (desktopë dhe laptopë) funksionalë që disponon Universiteti... ..	47
Tabela 15: Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme	47
Tabela 16: Programet e studimit	48
Tabela 17: Akreditimi i programeve.....	52
Tabela 18: Akreditimi Institucional	53
Tabela 19: Numri i studentëve të pranuar në vitin akademik 2023/2024. Niveli Bachelor.....	53
Tabela 20: Numri i studentëve të pranuar në vitin akademik 2023/2024 Niveli Master	54
Tabela 21: Numri i studentëve të pranuar në të gjitha vitet akademike. Niveli Bachelor	54
Tabela 22: Numri i studentëve të pranuar në të gjitha vitet akademike. Niveli Master.....	55
Tabela 23: Numri i studentëve të transferuar, Niveli Bachelor	56
Tabela 24: Numri i studentëve të transferuar, Niveli Master.....	57
Tabela 25: Numri i studentëve të diplomuar në të gjitha vitet akademike. Niveli Bachelor	57
Tabela 26: Numri i studentëve të diplomuar në të gjitha vitet akademike. Niveli Master	58
Tabela 27: Numri i studentëve aktiv në vitin akademik 2023/2024. Niveli Bachelor.....	59
Tabela 28: Numri i studentëve aktiv në vitin akademik 2023/2024. Niveli Master	59
Tabela 29: Numri i studentëve të çregjistruar në të gjitha vitet akademike. Niveli Bachelor	60
Tabela 30: Numri i studentëve të çregjistruar në të gjitha vitet akademike. Niveli Master	61
Tabela 31: Lista e disa prej publikimeve shkencore relevante nga fushat e ndryshme studimore të stafit akademik të Fakultetit të Edukimit, gjatë vitit 2023	62
Tabela 32: Lista e pjesëmarrjes në konferenca dhe punëtori të ndryshme	66
Tabela 33: Punimet e publikuara	69
Tabela 34: Punimet e publikuara	71
Tabela 35: Lista e punimeve shkencore të stafit akademik të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, gjatë vitit 2023	72

Fjala hyrëse e Rektorit

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, nëpërmjet veprimtarisë së tij gjatë vitit 2023, ka vazhduar të ndërtojë mbi traditën e konsoliduar në promovimin e filozofisë së lirisë, të një shoqërie të lirë dhe moderne. Institucioni ka kontribuar në avancimin e vlerave të demokracisë, zhvillimin e mendimit kritik dhe të individit të lirë, si dhe në fuqizimin e kulturës pozitive kombëtare dhe shtetërore.

Me hyrjen në epokën e informacionit dhe teknologjisë, Universiteti "Kadri Zeka" ka ndërmarrë hapa të qartë për të përshtatur operacionet dhe orientimin e saj në këtë kontekst të ri. Kjo tranzicion ka rëndësi të veçantë në kontekstin ku statusi i dijes po transformohet me ritme të shpejta, duke nxjerrë në pah nevojën për një qasje të përgjegjshme dhe të etikuar ndaj dijes dhe mundësive që ajo ofron.

Në lidhje me angazhimin ndaj tregut të punës, Universiteti ka zbatuar dy strategji kyçe:

Hulumtimi shkencor është orientuar drejt kontributit në ekonomi dhe komunitet, çka ka rezultuar në krijimin e marrëveshjeve bashkëpunuese me partnerë të ndryshëm gjatë vitit 2023.

Përgatitja e studentëve për tregun e punës është prioritet, duke u siguruar që ata të jenë të pajisur profesionalisht pas përfundimit të studimeve. Kjo përfshin rritjen e fokusit në praktikat profesionale, analizat e tregut të punës dhe harmonizimin e programeve studimore me kërkesat e tregut.

Ndërkohë, në skenën ndërkombëtare, Universiteti "Kadri Zeka" ka shënuar përparime të qartë në vitin 2023:

Është vërejtur një rritje në publikimet shkencore të stafit të Universitetit në revistat ndërkombëtare me impakt faktor, të indeksuara në rrjetet e njohura si Web of Science dhe Scopus.

Ka pasur një zgjerim të pjesëmarrjes së stafit akademik dhe administrativ në projektet ndërkombëtare, veçanërisht në ato të programit Erasmus+. Kjo demonstroi angazhimin e stafit për të kontribuar në projekte ndërkombëtare dhe dëshiron angazhimin e universitetit për të konkurruar në tregun evropian të arsimit të lartë.

Përmbledhur, viti 2023 ka sjellë rezultate pozitive për Universitetin "Kadri Zeka", duke e konfirmuar si një partner të besueshëm dhe të rëndësishëm për arsimimin e të rinjve, përgatitjen e tyre për sfidat profesionale, si dhe formimin e tyre si qytetarë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm.

Me respekt,

Prof.Asoc.Dr. Artan Dërmaku

HYRJE

Raporti është përgatitur në mbështetje të Nenit 24, pika 1, të Statutit të Universitetit publik "Kadri Zeka" në Gjiilan. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 paraqet një dokument përmbledhës të aktiviteteve të veprimtarisë të UKZ-së që përfshin periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Raporti vjetor i punës për vitin 2023 karakterizohet me menaxhimin e aktiveteve në dy periudha kohore nga dy rektorë dhe atë:

- Janar-shtator 2023 nga ish rektori Prof.Dr. Bajram Kosumi, dhe
- Tetor-dhjetor 2023 nga rektori aktual Prof.Asoc.Dr.Artan Dërmaku.

METODOLOGJIA E HARTIMIT

Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Universitetit publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, është hartuar bazuar në aktiviteteve të planeve të punës/veprimit të veprimtarisë të UKZ-së që përfshin periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Në pjesën e parë të muajit shkurt / 2023 në mbledhjen e kolegjiut me përfaqësimin e meaxhmentit të lartë, dekanëve dhe administratës është formuar grupi i gjërë punues me përfaqësues të Rektoratit në nivel të prorektorëve, të njësive akademike/ fakulteteve në nivel të dekanëve, të administrates në nivel të sekretarit të përgjithshëm, drejtorëve dhe udhëheqësve të zyrave. Detyrë e këtij grupi ishte angazhimi që në një proces konsultativ të bëjë mledhjen dhe dorëzimin e materialeve të raporteve të punës sipas njësive organizative akademike dhe administrative në funksion të para përgatitjes së Raportit vjetor të punës për vitin 2023 në nivel të UKZ-së.

Rrektori i Universitetit, Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, më dt. 08.03.2023, formoi grupin e punës për përgatitjen e Raportit Vjetor të Punës së UKZ-së për vitin 2023, në përbërje të:

1. Prof. Asoc. Dr. Naim Mustafa,
2. Prof. Dr. Sadik Haxhiu,
3. Dr.Sc. Vaxhid Sadriu,
4. MSc. Fitore Malaj, dhe
5. Luljetë Berisha.

Grupi punues pas pranimit të materialeve të raporteve të punës sipas njësive organizative akademike dhe administrative, hartoi Raportin vjetor të punës për vitin 2023 në nivel të UKZ-së dhe e procedoi për shqyrtim dhe publikim në Këshillin Drejtues (KD).

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më dt. 25.03.2026 mori vendim për publikimin e Raportit vjetor të punës të UKZ-së për vitin 2023, dhe rekomandoi që i njëjti t'i dërgohet MASHTI-it sipas procedurave të parapara me Statutin e UKZ-së.

1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE TË ARRITURA

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan gjatë vitit 2023 ka vazhduar veprimtarinë e tij, duke krijuarkushte për studentët dhe stafin e UKZ-së; për krijimin dhe avansimin e vlerave themelore njerëzore, për secilën kohë dhe në çdo hapësirë, e përcaktuar nga vizioni i UKZ-së. Veprimtaria e UKZ-së edhe gjatë vitit 2024, vazhdon të kultivojë nxënien dhe zhvillimin e dijeve, nxitjen e mendimit kritik dhe shpirttë ndërmarrësisë për hulumtime të reja, të cilat e ndihmojnë zhvillimin shoqëror dhe atë teknologjik. Gjithashtu, përgatit të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie virtuale dhe globale; për të qenë pjesë e një tregu të hapur të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë, të përcaktuar nga misioni i UKZ-së (*Plani strategjik i UKZ 2017-2022, i rishikuar më 2020*).

Viti 2023 është vit kur është hartuar dokumenti më i rëndësishëm i zhvillimit të Universitetit - Këshilli Drejtues i UKZ-së ka miratuar Planin Strategjik të UKZ-së për periudhën 2023-2028 (Vendimi Ref.nr. 02/2936 të dt. 19.12.2023.)

Qëllimi i Planit Strategjik është të kapë themelet e një vizioni dhe të kuptimit të përbashkët, të rolit e të identitetit të UKZ-së në kontekstin e kërkesave të shumta dhe në ndryshim në nivel kombëtar, si dhe në një botë globale gjithnjë e më të ndërlidhur. Ciklet pesëvjeçare 2023-2027 të planifikimit dhe të zbatimit do të vendosen brenda këtij kuadri ose strategjie, në mënyrë që të shfrytëzohet plotësisht natyra dinamike e ndryshimit që duhet të mbajë gjallërinë e UKZ-së brenda trajektores së tij të parashikuar.

Viti 2023, shënohet me mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme të UKZ. Gjatë procesit të zgjedhjeve në UKZ, u zgjodhën organet udhëheqëse të UKZ, Rektori, Dekanët, Kryetari i Bordit Indistruar të UKZ, etj.

Menaxhmenti i ri, përcaktoi vizionin e ri të UKZ-së : *“Institucion i arsimit të lartë që synon cilësinë akademike, inovacionin, avancon dijen dhe është i përgatitur për të kontribuar dhe për t’iu pershtatur zhvillimeve dinamike shoqërore dhe ekonomike në vend dhe më gjerë”*.

Gjatë vitit 2023 UKZ-ja ka arritur suksese në këto objektiva të përgjithshme strategjike:

1. Objektivi strategjik: **Universiteti, shoqëria dhe tregu i punës të jetë një cikël dhe proces i ndërlidhur**

- Hulumtimet e zhvilluara të stafit akademik të UKZ-së janë të ndërlidhura me zhvillimin e shoqërisë, duke afirmuar shkencën dhe rezultatet, në mënyrë që t’u përgjigjen sfidave ekonomike, juridike, politike dhe edukative të shoqërisë. Është punuar që studentët tanë të pajisen me njohuri të transferueshme dhe pas diplomimit të jenë konkurrentë në tregun vendor, rajonal dhe evropian të punës, duke përfshirë sektorin privat dhe publik.
- UKZ ka organizuar **Konferenca** (Konferenca Vjetore AC UKZ 2023, “*Science and Technology in the Promotion of Human Values*”, debate dhe ligjërata nga personalitete

të ftuara), ka organizuar ekipe të ekspertëve nga fusha e ekonomisë (FEK), nga fusha e digjitalizimit (FSHK, strategjia “Smart City” (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/studentet-e-fshk-se-se-ukz-se-do-te-mund-ti-ndihmojne-komunes-se-gjilanit-ne-fushen-e-teknologjise-vecanerisht-ne-strategjine-smart-city/>), nga fusha e së drejtës (FJU, hulumtimi mbi Besueshmërinë e PKNë Gjilan (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/stafi-akademik-dhe-studentet-e-fakultetit-juridik-kane-realizuar-hulumtimin-mbi-besueshmerine-e-policise-se-kosoves-ne-gjilan/>), fusha e edukimit (FJU) dhe arsimit matematik (FSHA); duke ofruar ekspertiza dhe shërbime të tjera profesionale për institucionet dhe shoqërinë (Komuna e Gjilanit, Gjyqësori, Shkollat, Garat e matematikës “Kenguro 2023”).

- **Zyra për Karrierë** ka themeluar **bazën e të dhënave** për të gjithë studentët që kanë diplomuar në UKZ-së.
- **Bordi Industrial Këshilldhënës** i UKZ-së ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme lidhjet akademike me industrinë dhe shoqërinë, duke shtrirë impaktin në mënyrë direkte dhe indirekte në zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror. Kjo është arritur, duke bashkëpunuar me Bordin Këshilldhënës për organizimin e takimeve, Konferencës Vjetore të UKZ-së 2023 bashkëpunimit në procese të krijimit të programeve të reja, në proceset e ri-akreditimit të programeve studimore, duke i përgatitur ato konform kërkesave të punëdhënësve potencialë, me qëllim që studentët e diplomuar më lehtë të inkorporohen në tregun e punës. Zgjedhjet e mandatit vijuese të Bordi Industrial Këshilldhënës i UKZ-së janë mbajtur më 23.11.2023, me ç'rast janë konstitue organet dhe është zgjedhë kryetari për mandatin vijues 2023-2027.

2. Objektivi strategjik: **Avancimi i programeve studimore në tri nivelet e studimeve**

- Për programet master të ri-akredituara dhe ato të akredituara, ka vazhduar mesazhin e suksess organizimi dhe realizimi i aktiviteteve mësimore hulumtuese **të studentëve master** në FED, FJU, FSHK, përfshirë edhe diplomimin e studentëve. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave Aplikative janë formuar grupe të punës për zhvillimin e programeve studimore të nivelit të 5-të. Po ashtu, kanë vazhduar kontaktet dhe shqyrtimi i mundësive për studimet e doktoratës me universitetet partnere.

3. Objektivi strategjik: **Të rritet gjithëpërfshirja e studentëve në aktivitetet universitare dhe komunitare.**

- UKZ-ja ka organizuar aktivitete,
- Gjatë vitit 2023 janë realizuar aktivitete për **mobilitetin e studentëve**, në kuadër të bashkëpunimit me universitetet e tjera partnere të UKZ-së:
- UKZ-ja ka realizuar edhe mobilitet për studentët e universiteteve të tjera në UKZ
- Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor në Universitetet e tjera
- Me aktivitete të ndryshme të studentëve në UKZ, promovohet **rritja e konkurrencës**

ndërmjet studentëve për arritjen e njohurive dhe aftësive në fushat e tyre të studimeve. *Diploma student i dalluar*, e cila u ndahet çdo vit studentëve, të cilët arrijnë suksesin më të lartë në nivel të njësive akademike (*Diploma student i dalluar* 2023: linku përkatës)

- Këshilli Drejtues i UKZ-së në bazë të kriterëve, të cilat i cakton Senati i UKZ-së (këshilli drejtues për bursat e studentëve.
- Me rastin e përvjetorit të UKZ-së, janë ndarë edhe 5 diploma për studentët e dalluar nga 5 fakultetet e UKZ-së. Po ashtu, janë ndarë bursat universitare për studentë nga të gjitha njësive akademike të UKZ-së.
- Prezantimi i hulumtimit të grupit të studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike (digjitalizimi i procesit mësimor në UKZ-së.
- është organizuar trajnimi dhe certifikimi jashtëkurrikular në FSHK “Kursi për

4. Objektivi strategjik: **Burimet njerëzore- zhvillimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore**

- Në vitin 2023 UKZ-ja me sukses ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm dhe gjithmonë me kohë ka proceduar me procedurat e realizimit të **planifikimit të stafit akademik dhe administrativ**, duke filluar nga njësive akademike nëpërmjet Këshillave të Fakulteteve; përkatësisht nga njësive administrative, për të vazhduar me Komisionet e tjera, si: Komisionet recensuese, Komisionet për shqyrtimin e ankesave, Komisionin e Studimeve të Senatit dhe mbledhjeve të Senatit. Senati i UKZ-së gjatë vitit 2023 ka realizuar gjithsej 15 mbledhje (Po ashtu është konsultuar edhe përbërja e re e Senatit .
- Në muajin shkurt 2023 është proceduar me Konkursin e shpallur për Zgjedhjen/Rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik të shpallur më. Në këto dy konkurse, u avancua personeli akademik: Fakultetin e Edukimit janë tre (3) pozita mësimdhënës, Fakultetin Juridik janë tre (3) pozita mësimdhënës, Fakultetin Ekonomik janë tre (3) pozita mësimdhënës dhe në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike janë tre (3) pozita mësimdhënës.
- Gjatë vitit 2023, duke qenë se UKZ-ja është pjesë e projekteve Erasmus+, në kuadër të të cilave janë zhvilluar edhe **trajnime të rëndësishme për stafin akademik dhe administrativ**; një numër i madh i stafit akademik dhe administrativ kanë realizuar trajnime të ndryshme në vend dhe jashtëvendit.
- Gjatë muajit shkurt, mars 2023, ka filluar realizimi i bashkëpunimit të UKZ-së me Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie të Universitetit të Prishtinës dhe janë realizuar trajnime për 20 mësimdhënës të UKZ-së.

5. Objektivi strategjik: **Sistemi i Sigurimit të Cilësisë– sigurimi dhe ngritja e cilësisë**

- Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi, ka koordinuar punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e ri-akreditimit të programeve, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përfshijnë këto procese, po ashtu, koordinon punën e Zyrës me senatin e UKZ-së, Këshillin Drejtues, Njësive Akademike, Institutet, si dhe me këshillat,

komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura.

- Në vitin 2023, si pjesë e sitemit të sigurimit të cilësisë është rishikuar edhe **Kalendari Vjetor për Sigurimin e Cilësisë**. Kalendari vjetor përmban të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurim të cilësisë në UKZ. Planifikimi i aktiviteteve është bërë në baza javore, me ç'rast janë paraparë përgjegjësitë për secilin aktivitet. Kalendari i cilësisë është hartuar duke u bazuar në të gjitha rregulloret dhe dokumentet e miratuara në Senat, që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në UKZ. Përgjegjës për mbikëqyrjen e realizimin e aktiviteteve të planifikuara në këtë kalendar është ZZHAC-ja.
 - **Këshilli për Mbikqyrje të Cilësisë dhe Vlerësim (KMCV)** gjatë vitit 2023 ka mbajtur mbledhje të rregullta, në të cilat janë shqyrtuar monitorimi, vlerësimi dhe raportimi për cilësinë në njësitë akademike dhe të UKZ-së në tërësi.
6. Objektivi strategjik: **Përmirësimi dhe promovimi/përkrahja e punës kërkimore-shkencore**
- Në bazë të **Rregullores për Veprimtari Kërkimore-Shkencore** në UKZ është shpallur thirrja për përkrahjen e punës shkencore të në UKZ
 - UKZ-ja ka organizuar me sukses **Konferencën Vjetore të UKZ-së ACUKZ 2023** më 01-02 Qershor 2023 (<https://conference2023.uni-gjilan.net/>). Këshilli Organizativ i Konferencës ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Janë organizuar 6 sesione: sesiioni plenar me temën qendrore “Science and Technology in the Promotion of Human Values”, në të cilën kanë prezantuar personalitete të njohura shkencore. Po ashtu, janë organizuar edhe 5 sesione paralele për secilën prej fushave të Edukimit, Ekonomikut, Shkencave Kompjuterike, Juridikut, dhe Matematikës. Në kuadër të Konferencës është ndarë edhe çmimi i Konferencës me emrin “Marin Barleti”, i cili kësaj radhe iu dha akademikut nga ASHAK akad. Fejzullah krasniqi.
 - Këshilli Shkencor i UKZ ka shpallur Thirrjen për Mbështetje Financiare të punimeve shkencore të stafit akademik të UKZ-së në ueb-faqen e UKZ-së.
 - Bazuar në Rregulloren për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Këshilli Shkencor ka proceduar edhe shpalljen e **hulumtuesit më të mirë të vitit 2023**, e cila është shpallur në ceremoninë e përvjetorit të UKZ-së.

Si një institucion i ri i ndërtuar mbi traditën e mësimdhënies, ne si UKZ duam të ndajmë njohuri për të sfiduar dhe transformuar studentët tanë, duke u dhënë të rinjëve të të gjitha moshave dhe prejardhjeve mundësinë për të kontribuar në ndryshime pozitive, duke përmirësuar jetën e tyre dhe të të tjerëve.

Rritja e parashikuar e UKZ në regjistrimet gjatë viteve të ardhshme do të fokusohet në arritjen e një raporti të përshtatshëm të studimeve universitare me ato pasuniversitare (shkollimin e mesëm), dhe të kërkimit ndaj kualifikimeve profesionale të nivelit të lartë.

Përmes objektivave strategjike të arritura për vitin 2023, UKZ-ja zhvilloi aktivitetet e saj në frymën e urës lidhëse midis vlerave lokale, vlerave nacionale dhe vlerave globale. Asgjë më shumë se universiteti nuk na bënë konkurrentë në tregun global.

- Zgjedhjet e Përgjithshme në UKZ

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan, në vitin 2023 ka mbajtur zgjedhjet e Përgjithshme. Këshilli Drejtues në mbledhjen XX date 27.03.2023, kishte marr vendim për shpalljen e Zgjedhjeve të Përgjithshme në UKZ. Zgjedhjet e Përgjithshme mbahen me qëllim të konstituimit të këshillave të njësive akademike, Senatit, Zgjedhjen e Rektori dhe Zgjedhjet e Studentëve.

Zgjedhjet studentore i prijnë hapjes së procesit zgjedhor sa i përket zgjedhjeve të përgjithshme në UKZ dhe me këtë rast Këshilli Drejtues në mbledhjen e dates 04.04.2023, kishte marr vendim mbi themelimin e Komisionit zgjedhor i cili do të organizojë zgjedhjet studentore.

Komisioni Zgjedhor i cili udhëheq me procesin zgjedhor përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm si kryetar i komisionit, një përfaqësues nga MASHTI dhe përfaqësuesit e organizatave studentore.

Po ashtu komisioni qendror zgjedhor ka zgjedhur edhe komisionet zgjedhore në njësive akademike, ku kanë qenë të përfaqësuar të gjitha organizatat studentore me komisoner dhe pjesa tjetër e komisionereve ka qenë në përbërje nga stafi administrative i UKZ.

Duhet theksuar se sa i përket zgjedhjeve studentore universiteti ashtu siç edhe është e përcaktuar për monitorim e zgjedhjeve studentore e fton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës të cilët edhe këtë proces zgjedhor të mbjatur në UKZ më 2023 e kanë monitoruar dhe kanë dhënë një vlerësim maksimal në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Po ashtu Komisioni Qendror Zgjedhor ka furinizuar universitetin me gjithë materialin e nevojshëm për mbjatin e zgjedhjeve studentore në UKZ.

Zgjedhjet studentore në universitetin Publik “Kadri Zeka” Gjilan, janë mbjatur me date 4.5.2023 dhe procesi zgjedhor ka filluar në ora 07.00 dhe ka përfunduar në ora 19.00 dhe i gjithë procesi zgjedhor ka shkuar pa asnjë vërejtje.

Me përfundimin e procesit zgjedhor komisionet zgjedhor në fakultet kanë numëruar votat dhe nga ky process zgjedhor të dy organizatat pjesmarrëse në zgjedhjen kanë zgjedhur përfaqësuesit e tyre.

Universiteti ka shpallur rezultatet preliminare dhe pas tyre edhe rezultatet përfundimtare dhe ndaj këtij procesi zgjedhor nuk ka pasur asnjë ankesë apo vërejtje.

Sipas agjendës të cilën e kishte miratuar Këshilli Drejtues i UKZ – së për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor janë konstituuar të gjitha organet studentore, duke përfshirë organet studentore në fakultet dhe konstituimin e parlamentit studentor.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka mbajtur gjatë vitit 2023 edhe zgjedhjet për këshillat e fakulteteve dhe ku të gjitha këshillat e fakulteteve janë konstituuar në kohë.

Me procesin e zgjedhjeve ka udhëhequr Komisioni zgjedhor i përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm dhe dy profesor të zgjedhur si anëtar të komisionit zgjedhor.

Pas konstituimit të këshillave të fakulteteve komisioni zgjedhor ka organizuar edhe procesin e zgjedhjeve për anëtar të Senatit nga stafi akademik dhe ai administrativ.

Me datë 19.04.2023 ashtu siç përcaktohet në rregulloren për zgjedhjet e përgjithshme stafi akademik dhe administrativ kanë aplikuar për tu zgjedhur anëtar të Senatit.

Më datë 25.04.2023 janë mbajtur zgjedhjet për anëtar të Senatit ku edhe ky proces zgjedhor ka rrjedhur shumë mire ku nga të gjitha njësitë akademike janë zgjedhur senatorët dhe po ashtu është zgjedhur edhe anëtari i senatit nga stafi administrative.

Me datë 18.05.2023, pas përfundimit të zgjedhjeve studentor dhe atyre për senat sipas agjendës së paraparë janë mbajtur mbledhjet konstituive të Këshillave të Fakulteteve, ku janë bërë verifikimi i anëtarëve të këshillave, zgjedhja e dekanëve të përkohshëm për Senat dhe zgjedhja e dekanëve.

Më datë 22.5.2023 është mbajtur mbledhjen konstituive e Senatit të UKZ, ku është zgjedhur kryesuesi i përkohshëm i Senatit, verifikimi i mandateve të anëtarëve të Senatit nga stafi akademik, administrativ dhe studentëve dhe më pastaj ka vazhduar me procesin e votimit për zgjedhjen e dekanëve dhe të gjithë dekanët të cilët janë miratuar në njësitë përkatëse akademike janë votuar me vendime unanime të anëtarëve të senatit.

Duhet theksuar se ky proces zgjedhor ka rrjedhur mirë dhe nuk ka pasur anjë ankesë sa i përket këtij procesi zgjedhor.

Me datë 7.6.2023 Këshilli Drejtues kishte marr vendim për shpalljen e konkurist për Rektor në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Me datë 8.6.2023 është shpallur dhe konkursi ka qenë i hapur për 15 ditë.

Në konkursin për rektor kanë konkuruar tre kandidatë të brendshëm Prof.Asoc.Dr. Artan Dërmaku, Prof.Asoc.Dr. Dukagjin Leka dhe Prof.Asoc.Dr. Xhevat Sopi, Prof.Ass.Dr. Fadil Osmani dhe Dr. Xhavit Islami.

Pas verifikimit të dokumentacionit komisioni kishte konstatuar se kandidatët Prof.Asoc.Dr. Artan Dërmaku, Prof.Asoc.Dr. Dukagjin Leka dhe Prof.Asoc.Dr. Xhevat Sopi dhe Prof.Ass.Dr. Fadil Osmani i kanë plotësuar kushtet formalo – juridike për pozitën e rektorit.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 6.7.2023 ka zgjedhur Prof.Asoc.Dr. Artan Dërmaku, Rektor të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Me zgjedhjen e rektorit të ri është përmbyllur procesi për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Duhet theksuar se i gjithë procesi zgjedhor ka shkuar mbarë si në zgjedhjet studentore, këshilla të fakulteteve, senat dhe rektor.

Gjatë tërë këtij procesi Komisioni Zgjedhor nuk ka pranuar asnjë ankesë apo vërejtje.

- *Hartimi i Planit Strategjik 2023-2028*

Ciklet pesëvjeçare 2023-2028 të planifikimit dhe zbatimit janë vendosur brenda këtij kuadri/strategjie në mënyrë që të shfrytëzohet plotësisht natyra dinamike e ndryshimit që duhet të mbajë gjallërinë e Universitetit Publik “Kadri Zeka” brenda trajektores së tij të parashikuar.

Qëllimi i Planit Strategjik është të kapë themelet e një vizioni dhe kuptimit të përbashkët të rolit dhe identitetit të Universitetit në kontekstin e kërkesave të shumta dhe në ndryshim - në nivel kombëtar dhe në një botë globale gjithnjë e më të ndërlikuar. Ciklet pesëvjeçare 2023-2028 të planifikimit dhe zbatimit do të vendosen brenda këtij kuadri/strategjie në mënyrë që të shfrytëzohet plotësisht natyra dinamike e ndryshimit që duhet të mbajë gjallërinë e Universitetit Publik “Kadri Zeka” brenda trajektores së tij të parashikuar.

Pas punës së bërë nga grupet punuese dhe pas disa punëtorive të zhvilluara me hisedarët e brendshëm dhe të jashtëm, Këshilli Drejtues i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, në mbledhjen e XXXII e cila është mbajtur më datë 19.12.2023, miratoi Planin Strategjik të UKZ-së për periudhën 2023 – 2028. Ky Plan Strategjik parashihet të ndihmojë në rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e universitetit, duke iu përgjigjur sfidave të ndryshme në fushën akademike dhe duke përmirësuar përvojën e studentëve dhe personelit akademi

- *Akreditimi Institucional*

Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të procesit të Riakreditimit Institucional, Rektori dhe Menaxhmenti kanë bërë mobilizimin e gjithë stafit të Universitetit duke u nisur nga prorektorët, dekanët, dhe stafi tjetër akademik e administrativ.

Për këtë Rektori Dërmaku ka marrë vendim duke krijuar edhe agjendën për grupet punuese për secilin standard veç e veç (11 standarde në total), të cilat grupe janë duke punuar në shkrimin e Raportit të Vetëvlerësimit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Në kuadër të këtij procesi deri tani të gjitha dokumentet e kërkuara janë dorëzuar me kohë duke përfshirë edhe tabelën me bartës të gjitha programeve studimore si dhe përfundimin e deklaratimit të Stafit Akademik në platformën E-Akreditimi.

- *Aplikimi për akreditim i programeve ekzistuese dhe të reja*

UKZ ka aplikuar për Ri/Akreditim të programeve studimore si në tabelën në vijim:

Tabela 1: UKZ ka aplikuar për Ri/Akreditim të programeve studimore

Fakulteti	Programi	Akredituar	Riakredituar	Riakredituar
EDUKIMI	Arsimi Parashkollor	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016 - 30.09.2020 01.10.2021 - 30.09.2024	Në proces
	Arsimi Fillor	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016 - 30.09.2020 01.10.2021 - 30.09.2024	Në proces
EKONOMIK	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar	01.10.2014 - 30.09.2017	01.10.2017- 30.09.2020 01.10.2021- 30.09.2024	Në proces
	Menaxhim dhe Ndërmarrësi	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10. 2016 - 30.09.2019 01.10.2020 - 30.09.2023	
JURIDIK	Juridik i Përgjithshëm	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016 - 30.09.2019	Deri 30.09.2025
SHKENCA KOMPJUTERIKE	Shkencat Kompjuterike	01.10.2014 - 30.09.2016	01.10.2016 - 30.09.2019	Deri 30.09.2026
SHKENCAT APLIKATIVE	Matematikë Arsimore	1.10.2019 - 30.09.2022		
1.UKZ, Gjilan/ F. Juridik 2.UUH, Prizren/ F. Juridik 3. UHZ, Pejë/ F. Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	01.10.2017 - 30.09.2021		
UKZ, Gjilan: 1.Fshk 2.Fakulteti Juri.dik 3.Fakulteti Ekonomik	E – Qeverisja	01.10.2017 - 30.09.2021	01.10.2021 - 30.09.2024	Në proces
Fakulteti i Edukimit	Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe	1.10. 2021 30.09.2024	Në proces	
	Mësimdhënie e Kurrikula për Programin Fillor	1.10. 2021 - 30.09.2024	Në proces	
Fakulteti Juridik	Juridiko Penal	1.10. 2021 - 30.09.2024	Në proces	
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale	1.10. 2021 - 30.09.2024	Në proces	

Ndërsa si programe të reja, UKZ ka aplikuar në këto dy programe:

- Marrëdhënie Ndërkombtare dhe Studime Evropiane - Bachelor
- Mësimdhënie në Gjuhën Angleze – Master

- ***Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar***

Hapësira e bashkëpunimit ndërkombëtar është zgjeruar edhe më tepër. Edhe gjatë vitit 2023, UKZ është bërë pjesë e disa projekteve Erasmus+ ICM. Projektet ERASMUS+ CBHE të cilat kanë filluar në vitin 2020, janë përmbyllur me sukses në vitin 2023.

Në kuadër të projekteve Erasmus+, është realizuar dhe rritur numri i mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve. Nga të gjitha njësitë akademike dhe administrative, stafi ka lëvizur në trajnime dhe vizita të ndryshme studimore dhe ka përfituar përvoja të reja në fushat që ju përkasin.

- ***Hapësira dhe infrastruktura***

Gjat vitit 2023, vazhduan aktivitete në drejtim të krijimit të hapësirave të reja në objektin egzistues, duke rinovuar disa salla mësimi dhe duke krijuar hapësira të reja për zyrtarët administrativ. Ndër to janë: Renovimin e salles mesimore në amfiteater; Renovimi I sallave tjera mësimore dhe zyrave; Furnizimi dhe instalimi i liftit në hyrjen A në UKZ; Parkingu; Furnizim me pajisje të IT-së; Furnizim me printer multifunksional Furnizimi dhe instalimi me kamera në UKZ.

2. PUNA E ORGANEVE QE VERISËSE

2.1. Të dhëna për Këshillin Drejtues

Këshilli Drejtues gjatë periudhës një (1) vjeçare të vitit 2023, ka mbajtur shtatëmbëdhjetë (17) mbledhje dhe ka miratuar : Shtatëmbëdhjetë (17) rend dite dhe procesverbale;

Ka nxjerr gjashtëdhjetë e tre (63) vendime të ndryshme;

Planifikimin buxhetor për vitin 2023 dhe i vlerësimeve për vitet 2024 dhe 2025.

Këshilli Drejtues ka miratuar raportet tre, gjashtë, nëntë dhe dymbëdhjetë mujore të shpenzimeve të buxhetit.

Dinamikën e procesit të zgjedhjeve të pjesshme në UKZ-së;

- Këshilli Drejtues ka marr vendim për shpalljen e zgjedhjeve të përgjithshme dhe zgjedhjet e Studentëve në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.
- Këshilli Drejtues ka miratuar agjendën-dinamikën e procesit zgjedhor për zgjedhje të përgjithshme si dhe ka miratuar agjendën – planin operativ për zgjedhjet e studentëve në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.
- Këshilli Drejtues ka nxjerr vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore për zgjedhjet e përgjithshme në vlerë prej 7,350.00 euro kurse janë shpenzuar vetëm gjysma prej tyre.
- Po ashtu ka miratuar propozimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet e përgjithshme dhe studentore të UKZ-së për vitin 2023.
- Po ashtu ka themeluar edhe Komisionin zgjedhor në përbërje prej pesë anëtarëve të paraparë në nenin 13 parag.2 të Rregullores mbi zgjedhjet e studentëve si dhe në mbështetje të nenit 16 parag.2 , ka caktuar edhe stafin mbështetës administrativ teknik prej dy anëtarëve.
- Këshilli Drejtues ka marr vendim për shpalljen e Konkursit për Rektor të UKZ-së, dhe konkursi është publikuar me Nr.ref. 02/1079 të datës 8.06.2023.
- Këshilli Drejtues ka nxjerr vendim për zgjedhjen e Rektorit të UKZ-së. Mandati i Rektorit është katër vjeçar dhe fillon me 01 tetor 2023 dhe përfundon më dt. 30 shtator 2027.

Rektor është zgjedhur Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku.

Raportit të Komisionit Qendror Zgjedhor mbi ecurinë e zgjedhjeve të pjesshme në UKZ;

Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm si Kryetar i Komisionit Qendror Zgjedhor i cili është paraqitur para Këshillit Drejtues.

Planin strategjik 2023-2028 dhe raportit të vetëvlerësimit Institucional.

Këshilli Drejtues ka formuar grupin punues që do të udhëheq procesin e Akreditimit Institucional të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan dhe për mbikëqyrjen e ri/akreditimit të programeve studimore për vitin 2023/2024.

Ka miratuar Planin Strategjik për periudhën 2023-2024 të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Ref.nr. 02/2936 të dt. 19.12.2023.

Raportet e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në kuadër të KD - raporte;

Ka formuar komisionin për parashtrëse dhe ankesa të Këshillit Drejtues i cili i ka zgjidhur të gjitha ankesat dhe parashtrësat drejtuar KD por që nuk ka nxjerr një raport lidhur me këtë.

Propozimin dhe zgjedhjen e pesë Prorektorëve

- Këshilli Drejtues ka miratuar propozimin e Rektorit të UKZ-së për rritjen e numrit edhe të dy prorektorëve në UKZ, gjithsej pesë prorektorë.
- Këshilli Drejtues ka nxjerr vendimet për zgjedhjen e pesë Prorektorëve të UKZ-së.
- Prof. Dr. Sadik Haxhiu - Prorektor për Mësimdhënie dhe Çështjeve të studenteve
- Prof. Asoc. Dr. Naim Mustafa - Prorektor për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë
- Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka - Prorektor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe projekte
- Prof. Ass. Dr. Arbona Xhemajli – Prorektor për Hulumtime dhe Kërkime Shkencore
- Prof. Ass. Dr. Voglushe Kurtoshi - Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Propozimin për mbështetje financiare të punimeve të publikuara sipas Rregullores për kërkime shkencore në UKZ.

KD ka nxjerr vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore për bursa, mbështetje të kërkimeve shkencore për stafin akademik si dhe mbështetje të tjera eventuale për studentë.

Ndarja e mjeteve në shumë prej 100,000.00 euro nga kategoria subvencione dhe transfere:

65,000.00 euro për bursa të studentëve:

30,000.00 euro për mbështetje të kërkimeve shkencore për stafin akademik dhe

5,000.00 euro për mbështetje të tjera eventuale.

Kërkesën / Refuzimet

Këshilli Drejtues ka refuzuar kërkesa të ndryshme qoftë nga stafi akademik, administrativ dhe studentë.

Miratimi i rregulloreve :

- Këshilli Drejtues ka formuar komisionin për përgatitjen e Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesave sipas funksioneve dhe kompensimet e tjera në UKZ e cila rregullore edhe është miratuar.
- Ka miratuar Rregulloren për Punën e Këshillit Drejtues të UKZ-së.
- Ka miratuar Rregulloren për Kodin e Etikës së UKZ-së.
- Rregulloret mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe të studentëve.

Punët e tjera të Këshillit Drejtues

- Këshilli Drejtues ka marr vendim me të cilin e ka themeluar Njësinë Akadematike- Fakultetin e Shkencave Sociale, me programin e studimit “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane”, si program Bachelor me 180 ECTS në UKZ.
- Këshilli Drejtues ka dhënë edhe Konkluzione e Rekomandime të ndryshme.
- Ka miratuar raportin përfundimtar për Planin e Prokurimit për vitin 2023.

2.2. Të dhëna për Senatin

Senati gjatë periudhës një (1) vjeçare të vitit 2023, ka mbajtur pesëmbëdhjetë (15) mbledhje dhe ka miratuar : Pesëmbëdhjetë (15) Rend dite dhe procesverbale; Senati ka nxjerr shtatëdhjetë (70) vendime të ndryshme;

Kërkesën / Refuzimet

Senati ka refuzuar kërkesa të ndryshme qoftë nga stafi akademik, administrativ dhe studentë.

Miratimi i rregulloreve:

Senati ka Miratuar njëmbëdhjetë (11) Rregullore të UKZ-së të cilat janë harmonizuar me Statutin e ri të Universitetit:

- Miratohet Rregullorja mbi punën e Senatit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, Ref.nr. 01/2901 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Studimet Themelore- Baçelor e Këshillit të Fakultetit të Edukimit e Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2902 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Studimet Themelore- Baçelor për Këshillin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2903 të datës 18.12.2023.

- Miratohet Rregullorja për Studimet Themelore- Baçelor për Këshillin e Fakultetit Juridik të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref. Nr. 01/ 2904 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Mbështetje të Mobilitetit dhe Aktiviteteve të tjera të Stafit Akademik të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2907 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Studimet Themelore- Baçelor për Këshillin e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2908 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Punën e Këshillit Botues të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2909 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Programin Master E-QEVERISJA, Ref. Nr. 01/2910 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Themelimin dhe Funksionimin e Këshillit për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe për Vlerësim të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, ref. Nr. 01/2911 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Manuali për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2912 të datës 18.12.2023.
- Miratohet Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref. Nr. 01/2913 të datës 18.12.2023.
- Senati ka miratuar Planin Strategjik i Kërkimit Shkencor të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, Ref.nr. 01 / 2915 të datës 18.12.2023. Me projektin: ‘‘Rritja e kulturës kërkimore në arsimin e lartë në Kosovë’’, Shtator 2021. Akronimi: ResearchCult. Numri i projektit: 610000-EPP-1-2019-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP (2019-1992/001-001).
- Senati ka miratuar Rregulloren për Etikë dhe Integritet në Kërkimin Shkencor të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan, me Ref.nr. 01 / 2914 të datës 18.12.2023

Procesi i aplikimit për akreditim/riakreditim të programeve të studimit;

Senati ka nxjerr vendim për aplikimin e Akreditimit Institucional të Universitetit Publik ‘‘Kadri Zeka’’ në Gjiilan.

Shqyrtimi dhe marrja e vendimeve lidhur me propozimet e Këshillave të fakulteteve për aprovim të plan programeve të studimit:

- Senati ka miratuar propozimet e Fakulteteve për akreditim/ riakreditim të programeve.

- Senati ka formuar grupin punues për rishikimin e dokumenteve të UKZ-së për sigurimin e cilësisë.

Shpalljen e konkursit për rekrutimin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune dhe për bashkëpunëtorë të jashtëm; si dhe mbarëvajtja e procesit mësimor

- Senati ka miratuar propozimet e Këshillave të Fakulteteve për shpalljen e konkursit lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik për vitin 2023.
- Senati ka miratuar propozimet e Fakulteteve për shpalljen e konkursit për bashkëpunëtorë të jashtëm për semestrin veror dhe dimëror.

Vendime të tjera të Senatit:

- Senati ka miratuar propozimin e numrit të studentëve nga Fakultetet për regjistrimin e studentëve në Njësitë Akademike si dhe shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve të rinj në vitin e parë të studimeve bachelor për vitin 2023.
- Senati ka nxjerr vendim për shpalljen e konkursit plotësues në studimet bachelor dhe master.
- Senati ka miratuar propozimet e Këshillave të Fakulteteve për zgjedhjen e Dekanëve.
- Senati ka nxjerr vendime për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në thirrjen akademike të profesorëve.
- Senati ka formuar Komisionin e Ankesave të Senatit të UKZ-së.
- Senati ka formuar Komisionin e Studimeve në UKZ
- Senati ka formuar Këshillin Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ.
- Senati ka formuar Këshillin e Etikës së UKZ-së.
- Senati ka formuar Këshillin Shkencor të UKZ-së.
- Senati ka formuar komisionin profesional prej pesë (5) anëtarëve për përpilimin e listës formale të kandidatëve për Rektor të UKZ-së.

3. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME STATISTIKORE

3.1. Buxheti (fondet publike dhe private)

Raporti vjetor i buxhetit paraqet një dokument përmbledhës të buxhetit të UKZ-së për të hyrat dhe shpenzimet, që përfshin periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Zyra për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me zyrtaren certifikuese dhe Zyren e prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi përgaditë Raportin e detajuar finciar të buxhetit për të hyrat dhe shpenzimet e çështjeve kyçe në fushën e menaxhimit financiar që përfshin periudhën kohore kalendarike 01.01.2023 deri më 30.12.2023.

Raporti është përgatitur në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr.03/L-048) dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit (Nr.03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr. 03/L-221), neni 46 dhe Ligjit (Nr. 04/L-116) për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit (Nr. 03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin (Nr.03/L-221), dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme – Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i kontrollojnë një institucion i vetëm – Thesari. Pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur janë nën kontroll të Qeverisë. Kjo, përfshinë paratë të cilat janë transferuar në llogari të Thesarit në BQK, paratë që qëndrojnë në llogari nëpër banka komerciale në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e një organizate buxhetore në pritje për tu transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato paguhen nga llogaria e vetme e Thesarit. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës. Raporti financiar paraqet aktivitetin financiar ashtu siç është specifikuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048).


Buxheti i UKZ-së është i ndarë në mënyrë Institucionale, në të cilin janë të përfshira të gjitha njësitë akademike.

Në tabelën nr. 1 është i paraqitur buxheti dhe shpenzimet deri më 31.12.2023 si dhe struktura e shpenzimeve në raport me buxhetin total:

Tabela 2: Buxheti dhe Shpenzimet Janar – Dhjetor 2023

